

Bazuar në nenin 10 të Ligjit për pagesën e pagave në Republikën e Maqedonisë së Veriut (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 70/94, 62/95, 33/97, 50/01, 26/02, 46/02, 37/05, 121/07, 161/08, 92/09, 97/10, 11/12, 170/13, 139/14 dhe 147/15 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 202/19), Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë

PUBLIKON

1. Norma e shpenzimeve së jetesës për muajin tetor 2024, krahasuar me muajin shtator 2024, sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave (Kumtesa: Indekset e kostos së jetesës dhe çmimet me pakicë, tetor 2024, numër 4.1.24.100, publikuar më 07.11.2024), është më e ulët për 0,7 %.
2. Pagesën e pagave për muajin tetor 2024, në raport me muajin shtator 2024, e bëjnë punëdhënësit nga neni 3 paragrafi 1 i Ligjit për pagesën e pagave në Republikën e Maqedonisë së Veriut në nivel të së drejtës së përcaktuar për muajin paraardhës.



Nr. 08-4312/1
Dt.

12-11-2024